



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHERBIMEVE TE KUJDESIT SHENDETESOR
SPITALI RAJONAL SHKODËR

Nr. 1738/prot.

Shkodër, më 11.08.2021

Lënda : Kthim përgjigje

Drejtuar: Z. Dorian Matlija

Adresa : Qendra "Res Publica" Blv "Gjergj Fishta" nd.24. H.3, Ap.7 Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj me datë 26.07.2021 , protokolluar pranë institucionit tonë (Spitalit Rajonal Shkodër) me datë 30.07.2021 me nr. Prot 1738 në përputhje me Ligjin nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit regjistruar me nr. Rendor 111 sipas regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

Ju informojmë se:

Në Spitalin Rajonal Shkodër gjatë periudhës Shkurt-Prill 2021 janë trajtuar 60 pacientë ne repartin e terapisë intensive , dhe 188 pacientë ne repartin Infektiv (COVID) .

Spitali ka infrastrukturen e duhur për diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve me COVID, nga paneli analizave laboratorike tek ekzaminimet me skaner , grafi dhe trajtimin me medikamente sipas protokolleve përkatëse .

Në Spitalin Rajonal Shkodër gjatë vitit 2019 janë kryer me sukses 3385 ndërhyrje kirurgjikale, gjatë vitit 2020 janë kryer 2622 ndërhyrje kirurgjikale dhe në periudhën Janar-Qershor 2021 janë kryer me sukses 1533 ndërhyrje kirurgjikale .

Në kuadër të investimeve , gjatë periudhës së pandemisë janë shtuar linjat funksionale të burimeve të oksigjenit duke u plotësuar në 100% .

Për furnizimin e oksigjenit medikal spitali ynë ka lidhur kontratë, procedurë të cilën e gjeni të publikuar në APP.

Faleminderit për bashkëpunimin,

Koordinatori e Së Drejtës për Informim

Elona Barka

